



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Drejtoria e Integritimit dhe Projekteve

MBI PROGRAMIN E BURSAVE TË KËRKIMIT UNESCO/KEIZO OBUCHI

Në kuadër të Programit UNESCO/KEIZO OBUCHI, Qeveria Japoneze do të financojë 20 bursa studimi për vitin 2015. Programi i bursave të kërkimit, i cili ka filluar të zbatohet që në vitin 2000, parashikon akordimin e bursave individuale për kërkime të thelluara pasuniversitare për një periudhë 3 ose 9 mujore. Bursat ofrohen në katër fushat në vijim:

1. Mjedisi në shkencat e ujit;
2. Dialogu ndërkulturor;
3. Teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit;
4. Zgjidhja paqësore e konflikteve

Nënvizojmë se bursat akordohen për personat e diplomuar në programin e studimit MASTER në fushat e studimit për kërkime pasuniversitare ose specializime, të cilat përputhen me objektivat strategjike të Programit të Bursave të Kërkimit UNESCO/KEIZO OBUCHI.

Aplikantët, të cilët dëshirojnë të ndjekin punë kërkimore jashtë vendit, preferohen të aplikojnë në rajonin e tyre. Me qëllim zgjerimin e njohurive në një nga katër fusha specifike të mësipërme, ata duhet të plotësojnë kriteret në vijim:

- Të jenë kërkues në nivel pasuniversitar me titullin MA ose MSc. Përjashtohen nga aplikimi ata kandidatë që janë në proces të përfundimit të programit MASTER;
- Të kenë aftësi të mira intelektuale për kontribute në vendin e tyre;
- Të jenë jo më shumë se 40 vjeç. Aplikantët që kanë lindur para datës 1 janar 1975 nuk duhet të përfshihen në procesin e aplikimit;
- Të kenë dëshminë e pranimit nga një universitet ose një institucion kërkimor-arsimor në vendin ku ka aplikuar;
- Të kenë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze ose frënge, të cilat do të jenë edhe gjuhët e punës.

Për një informacion më të hollësishëm lidhur me bursat që ofrohen, mënyrën e plotësimit të formularit të aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit, referojuni adresave të internetit në vijim:

<http://www.unesco.org/new/en/fellowships/programmes/unescokeizo-obuchi-japan-young-researchers-fellowships-programme-unescokeizo-obuchi-research-fellowships-programme/>

<http://www.unesco.org/new/fr/fellowships/programmes/unescokeizo-obuchi-japan-young-researchers-fellowships-programme-unescokeizo-obuchi-research-fellowships-programme/>

Dokumentacioni, pasi të jetë plotësuar nga aplikantët, të dorëzohet në Sektorin e Integritimit dhe Projekteve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit deri në datën **8 dhjetor 2014**.

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE